



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ZHVILLIMIT URBAN
AGJENCIA KOMBËTARE E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT

Nr. 25/5 Prot

Datë 08.02.2017

AKT PËRPUTHSHMËRIE
PËR DOKUMENTET E
PLANIT TË PËRGJITHSHËM VENDOR
BASHKIA KORÇË

Në mbështetje të neneve 9, 23 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” i ndryshuar, të VKM Nr. 671, datë 29.07.2015 “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, të përcaktimeve të Planit të Përgjithshëm Kombëtar, të Vendimeve të Këshillit Kombëtar të Territorit lidhur me përcaktimin e çështjeve, shpalljen e zonave dhe objekteve të rëndësisë kombëtare në planifikim, të Strategjive Sektoriale në fuqi, të normave teknike të planifikimit si dhe të dhënave elektronike bazë, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit,

VENDOSI:

1. Lëshimin e Aktit të Përputhshmërisë për Dokumentet e Planit të Përgjithshëm Vendor:
 - i. “Strategjia Territoriale” - Bashkia Korçë;
 - ii. “Plani i Zhvillimit Territorial” - Bashkia Korçë;
 - iii. “Rregullorja e Planit” – Bashkia Korçë.
2. Pjesë përbërëse e këtij Akti Përputhshmërie është:
 - “Raporti i Vlerësimit Teknik” i Dokumenteve “Strategjia Territoriale”, “Plani i Zhvillimit Territorial”, “Rregullorja e Planit” të Bashkisë Korçë.

ADELINA GRECA

DREJTORE E AGJENCISË KOMBËTARE TË PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ZHVILLIMIT URBAN
AGJENCIA KOMBËTARE E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT

PLANI I PËRGJITHSHËM VENDOR *

STRATEGJIA TERRITORIALE
PLANI I ZHVILLIMIT TERRITORIAL
RREGULLORJA E PLANIT
BAZA E TË DHËNAVE

BASHKIA KORÇË

RAPORTI I VLERËSIMIT TEKNIK

Koordinator

Ekspert Ligjor

Ekspert GIS

Znj. Fiona Mali

Znj. Borana Laçi

Z. Evio Baruti



06.02.2017

| | | |
|---|---|--|
| Rezultatet dhe Detyrat | | Përputhshmëria VKM Nr. 671, datë 29.07.2015 Plani i Përgjithshëm Kombëtar |
| 1. STRATEGJIA TERRITORIALE | | |
| 1.1. ANALIZA E TERRITORIT | | |
| 1.1.1. Analiza e dokumenteve që prekin territorin, të hartuara më parë | 1.1.1.1. Analiza e planeve, strategjive, planeve sektoriale në të gjitha nivelet, përfshirë zbatueshmërinë e tyre dhe çështje që duhet të vlerësohen gjatë hartimit të planit të ri. | <i>Në përputhje</i> |
| | 1.1.1.2. Çështjet, zonat dhe/ose objektet e rëndësisë kombëtare që ndodhen në territorin e njësisë së qeverisjes vendore dhe kufizimet që rrjedhin prej tyre. | <i>Në përputhje</i> |
| | 1.1.1.3. Analiza e elementeve përjashtuese dhe paraqitjen e tyre grafike në hartë. | <i>Në përputhje</i> |
| 1.1.2. Analiza e Përgjithshme e Territorit | 1.1.2.1. Analiza dhe vlerësimin i pozicionimit strategjik të njësisë së qeverisjes vendore në raport me rajonin ku ajo shtrihet, përfshirë identitetin historik, urban dhe ekonomik të territorit. | <i>Në përputhje</i> |
| | 1.1.2.2. Analiza e përgjithshme e gjendjes ekzistuese të territorit të njësisë vendore dhe atë metabolike të flukseve kryesore, e cila përmban elementet: i) topografik dhe klimatik; ii) gjeologo-inxhinierik; iii) hidrogjeologjik dhe hidrografik; iv) makrozonimin dhe, sipas rastit, mikrozonimin sizmik; v) bonitetin e tokave, bazuar në vërtetimin e lëshuar nga autoriteti përkatës; vi) burimet natyrore, si mjedise pyjore, kullota, sipërfaqe ujore, rezervate, miniera dhe të tjera të kësaj natyre, nëse ka të tilla në territorin përkatës; vii) zonat e mbrojtura natyrore dhe të trashëgimisë kulturore dhe historike, nëse ka të tilla në territorin përkatës. | <i>Në përputhje</i> |
| | |  |

06.02.2017

1



| | | |
|--|--|---------------------|
| | 1.1.2.3. Analiza mjedisore | <i>Në përputhje</i> |
| | 1.1.2.4 Analiza e problematikës mjedisore, burimeve ndotëse dhe të dhëna për efektin e tyre në territor dhe shëndetin e njeriut | <i>Në përputhje</i> |
| | 1.1.2.5. Analiza e përgjithshme e kushteve dhe të cilësisë fizike të strukturave e të territoreve, si bazë për hartimin e planeve të rigjenerimit, ripërtëritjes dhe/ose rizhvillimit | <i>Në përputhje</i> |
| | 1.1.2.6. Analiza e tipologjisë hapësinore ekzistuese, bazuar në njëtrajtshmërinë e llojit dhe volumit të strukturave, mënyrën e vendosjes së tyre në njësi (strukturore), skemën e rrjetit rrugor dhe të hapësirave publike, si dhe në lartësinë e strukturave | <i>Në përputhje</i> |
| | 1.1.2.7. Analiza e elementeve të rëndësishme territoriale, natyrore apo artificiale, që kanë ndikuar ose ndikojnë në formimin e vazhdueshëm të territorit në studim | <i>Në përputhje</i> |
| 1.1.3. Përdorimi Ekzistues i Tokës; Aktivitetet dhe Impaktet | 1.1.3.1. Analiza e përdorimit ekzistues të tokës, bazuar në kategoritë bazë dhe nënkategoritë e përdorimit të tokës, funksionet dhe aktivitetet, si dhe lidhjen e territorit vendor me rrjetet e infrastrukturave kombëtare | <i>Në përputhje</i> |
| 1.1.4. Analiza dhe Vlerësimi Demografik | 1.1.4.1. Shpërndarja dhe përqëndrimi i popullsisë në territor, lëvizjet mekanike dhe natyrore në vite | <i>Në përputhje</i> |



06.02.2017

2

[Handwritten signatures in blue ink]

| | | |
|--|--|----------------------------|
| <p>1.1.5. Aspektet Sociale dhe Ekonomike</p> | <p>1.1.5.1. Analiza dhe vlerësimi ekonomik, përfshirë mundësitë lokale dhe pengesat për zhvillim ekonomik, konkurrueshmërinë ekonomike apo rajonale, pozicionimin dhe përqendrimin e poleve ekonomike lokale, cilësinë e kapitalit dhe të burimeve njerëzore, pika të forta apo të dobëta për zhvillimin e ardhshëm të territorit</p> | <p><i>Në përputhje</i></p> |
| | <p>1.1.5.2. Analiza dhe vlerësimi i problematikave sociale, përfshirë kriminalitetin, komunitetet e marginalizuara, etj.</p> | <p><i>Në përputhje</i></p> |
| | <p>1.1.5.3. Analiza e zhvillimit social, punësimit, edukimit, shëndetit etj.</p> | <p><i>Në përputhje</i></p> |
| | <p>1.1.5.4. Analiza e periferialitetit, për efekt të së cilës në territor përcaktohen zona sipas kriterëve të mëposhtme: i) largësia nga qendra/t e territorit urban; ii) largësia nga zonat ekonomike (qendrat e punësimit); iii) lidhja me rrjetin rrugor sipas kategorive të përcaktuara në Kodin Rrugor; iv) furnizimi me rrjete infrastrukture dhe shërbime sociale; v) niveli i përafërt i të ardhurave të shtresave shoqërore që ushtrojnë aktivitetin e tyre në zona të caktuara; vi) plotësimi me funksione sipas kategorive bazë të përdorimeve të tokës; vii) niveli i kriminalitetit dhe siguria e jetës; viii) probleme të ndryshme sociale, përfshirë përjashtimin social;</p> | <p><i>Në përputhje</i></p> |
| | <p>1.1.5.5. Analiza e nevojave për strehim për të gjitha grupet shoqërore, sipas llojit dhe cilësisë së banesave ekzistuese, shpërndarjes së tyre në territor, sipërfaqes së banimit për person dhe aksesit në shërbime</p> | <p><i>Në përputhje</i></p> |
| <p>1.1.6. Analiza e Infrastrukturës Ekzistuese</p> | <p>1.1.6.1. Infrastruktura rrugore, transporti dhe fluksi i lëvizjes së mjeteve (njësi/orë)</p> | <p><i>Në përputhje</i></p> |

06.02.2017 -



| | | |
|--|---|---------------------|
| 1.1.7. Toka dhe Çështjet e Pronës | 1.1.7.1. Analiza e mënyrës së përdorimit të pronave publike, përfshirë vendndodhjen, funksionet dhe marrëdhëniet e pronësisë | <i>Në përputhje</i> |
| | 1.1.7.2. Analiza e marrëdhënieve të pronësisë mbi tokën, përfshirë konfliktet dhe situatat e informalitetit | <i>Në përputhje</i> |
| 1.2. STRATEGJIA TERRITORIALE | | |
| 1.2.1. Parashikimet e detyrueshme që rrjedhin nga Planet Kombëtare dhe Sektoriale | 1.2.1.1. Parashikimet që rrjedhin nga Plan i Përgjithshëm Kombëtar | <i>Në përputhje</i> |
| 1.2.3. Rezultatet e Analizës së Territorit | 1.2.2 Përcaktimi i territorit në bazë të 5 sistemeve: urban, natyror, bujqësor, ujqor dhe infrastrukturor | <i>Në përputhje</i> |
| | 1.3.1. Identifikimi i problematikave dhe potencialeve për secilin nga 5 sistemet territoriale | <i>Në përputhje</i> |
| 1.2.4. Formulimi i vizionit dhe strategjisë për zhvillimin territorial të njësisë vendore | 1.2.4.1. Vizioni i zhvillimit të territorit të njësisë vendore | <i>Në përputhje</i> |
| | 1.2.4.2. Objektivat strategjike për zhvillimin e territorit të njësisë vendore | <i>Në përputhje</i> |
| | 1.2.4.3. Drejtimet për zhvillimin e territorit të njësisë vendore në bazë të treguesve të sistemeve, si dhe duke konsideruar projeksionet e ndryshimeve në: - popullsi; - aktivitet ekonomik; - cilësi mjedisi; - infrastrukturë publike; - shërbime publike; - sisteme territoriale në tërësi (konvertim nga një sistem në tjetrin); - etj. | <i>Në përputhje</i> |

06.02.2017



| | | |
|--|--|---------------------|
| 1.2.5. Programet, Projektet e Zhvillimit dhe Planet e tyre të Veprimit | 1.2.5.1. Programet dhe projektet kryesore të zhvillimit, të cilat pasqyrojnë përparësitë dhe drejtimet kryesore të planifikimit dhe të zhvillimit të territorit të njësisë vendore dhe mundësojnë realizimin e objektivave strategjikë. | <i>Në përputhje</i> |
| | 1.2.5.2. Planin e veprimeve për realizimin e programeve e të projekteve, përfshirë: - fazat dhe termat kohorë; - përgjegjësitë; - ndryshimet e nevojshme institucionale dhe ligjore; - burimet njerëzore; - buxhetin e nevojshëm për realizimin e planit të veprimeve; - treguesit monitorues të zbatimit. | <i>Në përputhje</i> |
| 1.2.6. Hartëzimi i Vizionit dhe Strategjisë së Territorit | 1.2.6.1. Hartat që paraqesin vizionin strategjik të zhvillimit të territorit të njësisë vendore si dhe drejtimet kryesore të planifikimit dhe të zhvillimit të territorit | <i>Në përputhje</i> |
| | 1.2.6.2. Hartat e 5 sistemeve ekzistuese dhe të propozuara territoriale së bashku me tabelat dhe treguesit përkatës për secilin sistem | <i>Në përputhje</i> |
| 2. PLANI I ZHVILLIMIT TË TERRITORIT | | |
| 2.1. Plani i Propozimeve Territoriale | 2.1.1. Ndarja e territorit sipas pesë sistemeve territoriale: urban, infrastrukturor, bujqësor, ujor, natyror, së bashku me tabelën dhe treguesit përkatës për secilin sistem (<i>shtojca III, VKM Nr. 671, datë 29.07.2015</i>). | <i>Në përputhje</i> |
| | 2.1.2. Zonimi sipas kategorive bazë dhe nënkategorive të përdorimit të propozuar të tokës. | <i>Në përputhje</i> |
| | 2.1.3. Ndarja e territorit në njësi. | <i>Në përputhje</i> |

06.02.2017



| | | |
|--|--|---------------------|
| | 2.1.4. Pozicionimi i rrjeteve të infrastrukturave, përfshirë hapësirat publike, dhe përcaktimi i kushteve teknike kryesore për realizimin e tyre. | <i>Në përputhje</i> |
| | 2.1.5. Zonat e rëndësisë kombëtare, të trashëgimisë kulturore dhe monumentet. | <i>Në përputhje</i> |
| | 2.1.6. Përcaktimi i zonave kryesore të zhvillimit ekonomik dhe urban. | <i>Në përputhje</i> |
| | 2.1.7. Tipologjitë e propozuara hapësinore, bazuar në përcaktimet e zonave/njësive për dendësim, rigjenerim, rizhvillim, konsolidim, konservim, urbanizim. | <i>Në përputhje</i> |
| | 2.1.8. Përcaktimi i njësive, të cilat do t'i nënshtrohen hartimit të PDV-ve sipas nenit 22 të ligjit, që parashikohet të kenë: - zhvillim dhe/ose rizhvillim; - ndryshim të përdorimit të tokës dhe kushteve të zhvillimit; - investime publike që ndikojnë në ndryshimin ose rishpërndarjen e treguesve të zhvillimit; - programe të transferimit të së drejtës për zhvillim dhe të intensitetit me kushte, sipas parashikimeve të PPV-së dhe drejttimeve të neneve 30 dhe 31 të ligjit. | <i>Në përputhje</i> |
| | 2.1.9. Shpërndarja e popullsisë në territor sipas treguesve të parashikimit demografik dhe ekonomik, të specifikuar në nivel territori urban. | <i>Në përputhje</i> |
| | 2.1.10. Plani i strehimit, bazuar në nevojat e konstatuara dhe të projektuara, duke përcaktuar zonat/njësitë për dendësim, rigjenerim, rizhvillim, konservim, urbanizim nëse janë zona të reja dhe territoret për programe sociale të strehimit. | <i>Në përputhje</i> |



06.02.2017

[Handwritten signatures]

| | | |
|---|---|---------------------|
| | <p>2.1.11. Përcaktimi i zonave/njësive, ku do të zbatohen instrumentet për drejtimin e zhvillimit sipas ligjit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Transferimi i së drejtës për zhvillim; - Intensiteti me kushte; - Zhvillimi i detyrueshëm i tokës; - Preferimi; - Pezullimi i zhvillimit; - Servituti publik. | <i>Në përputhje</i> |
| 2.2. Plani i Mbrojtjes së Mjedisit | 2.2.1. Parashikimet për mbrojtjen e peizazhit. | <i>Në përputhje</i> |
| | 2.2.2. Parashikimet për mbrojtjen e elementeve ujore. | <i>Në përputhje</i> |
| | 2.2.3. Parashikimet për shtimin dhe/ose zgjerimin e hapësirave të gjelbra. | <i>Në përputhje</i> |
| | 2.2.4. Parashtrimi i dy varianteve për zgjidhje të problematikës së evidentuar për sa u përket hotspotëve. | <i>Në përputhje</i> |
| | 2.2.5. Parashikimet për përmirësimin e cilësisë së ajrit. | <i>Në përputhje</i> |
| 2.3. Plani i Shërbimeve dhe Infrastrukturave Publike | <p>2.3.1. Infrastruktura publike që përfshin tërësinë e hapësirave dhe ndërtimeve ekzistuese ose të parashikuara, që synojnë realizimin e shërbimeve publike në:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Transport; - Energji; - Administrim të ujit; - Komunikim elektronik; - Administrim mbetjesh dhe mbrojtje e mjedisit; - Administrim burimesh natyrore dhe kulturore; - Mbrojtje kombëtare, civile e kundër zjarrit; - Etj. | <i>Në përputhje</i> |

06.02.2017



| | | |
|--|---|---------------------|
| | 2.3.2. Konsiderata nga planet e niveleve të tjera, sipas ndikimit në territorin vendor. | <i>Në përputhje</i> |
| | 2.3.3. Tipologjia, cilësia, shpërndarja në territor dhe rrezet e mbulimit të shërbimeve sociale (edukim, shëndetësi etj.) ekzistuese dhe të propozuara. | <i>Në përputhje</i> |
| 2.4 Plani i Veprimeve për zbatimin e PPV-së | 2.4.1. Fazat e zbatimit të zhvillimit, të ndara në periudha kohore brenda vlefshmërisë së planit për: - zonat me prioritet zhvillimi; - PDV-të; - rrjetet kryesore të infrastrukturave publike; - projektet prioritare/strategjike dhe projektet pilot. | <i>Në përputhje</i> |
| | 2.4.2. Kosto e përgjithshme për zbatimin dhe aktivitetet kryesore të financuara, të shoqëruara me planin e investimeve kapitale. | <i>Në përputhje</i> |
| | 2.4.3. Ndryshimet e nevojshme në kuadrin ligjor dhe administrativ në nivel vendor. | <i>Në përputhje</i> |
| | 2.4.5. Indikatorët për monitorimin e zbatimit të PPV-së. | <i>Në përputhje</i> |
| | | |
| 2.5. Shtojcat e PPV-së | 2.5.1. Dokumentet e përmendura për zbatimin e PPV-së, studimet ndihmëse që merren nga institucionet përgjegjëse për sektorë të caktuar, si dhe studime për qëllime të veçanta që ndërmerren nga vetë autoriteti vendor, sipas rastit. | <i>Në përputhje</i> |
| | 2.5.2. Shtojcat I-II-III të PPV-së sipas formatit të Rregullores së Planifikimit. | <i>Në përputhje</i> |

06.02.2017



| 3. RREGULLORJA E PLANIT | | |
|--------------------------------------|--|---------------------|
| 3.1. Përkufizime dhe Shpjegime | 3.1.1. Përkufizimet e termave të përdorur. | <i>Në përputhje</i> |
| | 3.1.2. Shpjegimin e kodeve të përdorura për: - kategoritë dhe nënkategoritë e përdorimit të tokës; - sistemet; - zonat; - njësitë; - kode të tjera sipas rastit | <i>Në përputhje</i> |
| 3.2. Rregullat e Përdorimit të Tokës | 3.2.1. Kategoritë bazë dhe nënkategoritë e përdorimit të tokës. | <i>Në përputhje</i> |
| | 3.2.2. Aktivitetet dhe funksionet në përputhje me kategoritë e përdorimit të tokës. | <i>Në përputhje</i> |
| | 3.2.3. Përdorimet që lejohen, ndalohen apo kushtëzohen, përfshirë kushtet përkatëse. | <i>Në përputhje</i> |

06.02.2017

[Handwritten signatures]



| | | |
|---|---|----------------------------|
| <p>3.3. Rregullat për çdo Zonë dhe Njësi</p> | <p>3.3.1. Kushtet e zhvillimit:</p> <p>Në nivel <i>zone</i>:</p> <ol style="list-style-type: none"> Kategoritë bazë; Nënkategoritë; Aktivitetet dhe funksionet e lejuara, të kushtëzuara dhe të ndaluara; Hapësira publike (S.UB.); Sipërfaqja bruto (S.UB.); Sipërfaqja neto (S.UB.); Sipërfaqja e infrastrukturës; Sipërfaqe Liqene, Lumenj, Përrenj, Ligatina (S.U.); Dendësia/ha (S.UB.); Njësi banimi/ha (S.UB.); Gjelbërimi (S.UB.); Parkimi (S.UB.); Ndarja në njësi. <p>Në nivel <i>njësie</i>:</p> <ol style="list-style-type: none"> Kategoritë dhe/ose nënkategoritë e përdorimit të tokës; Aktivitetet dhe funksionet e lejuara, të kushtëzuara dhe të ndaluara; Kushti për hartimin ose jo të PDV-së; Lloji i ndërhyrjes në territor (dendësim, rigjenerim, rizhvillim, konservim, konsolidim, urbanizim); Intensiteti i lejuar i ndërtimit (I); Koeficienti i shfrytëzimit të territorit (Ksht); Koeficienti minimal i shfrytëzimit të tokës për hapësira publike (Kshp); Koeficienti minimal i shfrytëzimit të territorit për rrugë (Kshr); Kushte për infrastrukturën; Lartësia e strukturave (në kate dhe metra); Treguesit e distancave; Tipologjia e ndërtimit; Vija e kuqe/ndërtimit; Numri minimal i vendparkimeve publike; Nr. Banorësh; Nr. Përdoruesish; Shërbime; Kushte të tjera, sipas rastit. | <p><i>Në përputhje</i></p> |
|---|---|----------------------------|

06.02.2017



| | | |
|---|---|----------------------------|
| | <p>3.3.2. Përcaktimi i instrumenteve të aplikueshëm për drejtimin e zhvillimit dhe zbatimin e PDV-ve (nënndarja dhe bashkimi i parcelave, intensiteti i ndërtimit me kushte, transferimi i së drejtës për zhvillim, etj), përfshirë të drejtat dhe kufizimet ligjore që rrjedhin prej tyre.</p> <p><i>(referuar Ligjit për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit – nenet 30-31, Rregullores së Planifikimit – neni 56, Rregullores së Zhvillimit – nenet 29-31; 41-44, si dhe Dokumentit të Politikave për Instrumentet Financiare për Zhvillimin e Tokës nga USAID-plgp).</i></p> | <p><i>Në përputhje</i></p> |
| | <p>3.3.3. Tabela përmbledhëse e të dhënave kryesore për të gjitha njësitë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - përdorimi i tokës, - ndërhyrja në territor, - kushti për PDV, - instrumenti për drejtimin e zhvillimit, - I, - Ksht, - nr. katesh, - nr. Banorësh. | <p><i>Në përputhje</i></p> |
| <p>3.4. Rregullat e Sistemit Rrugor dhe të Transportit</p> | <p>3.4.1. Përcaktimi dhe përshkrimi i kategorive të rrjetit rrugor, në përputhje me legjislacionin e posaçëm.</p> | <p><i>Në përputhje</i></p> |
| | <p>3.4.2. Kushtet teknike dhe përmasat.</p> | <p><i>Në përputhje</i></p> |
| | <p>3.4.3. Parametrat e skemës së lëvizshmërisë dhe të transportit publik, në përputhje me legjislacionin e posaçëm.</p> | <p><i>Në përputhje</i></p> |
| | <p>3.4.4. Përcaktimi i vijës së ndërtimit (vija e kuqe) përgjatë dy anëve të trupave rrugorë.</p> | <p><i>Në përputhje</i></p> |
| <p>3.5. Rregullat e Ruajtjes së Mjedisit, Peizazhit, Burimeve Natyrore, Zonave dhe Objekteve të Trashëgimisë</p> | <p>3.5.1. Normat dhe standardet për zhvillimet, që kanë ndikim në mjedis, shëndet, peizazh dhe në trashëgimi kulturore, sipas legjislacionit të posaçëm në fuqi.</p> | <p><i>Në përputhje</i></p> |
| | <p>3.5.2. Normat, standardet dhe rregullat për zonat dhe objektet e trashëgimisë</p> | <p><i>Në përputhje</i></p> |

06.02.2017



| | | |
|--|--|---------------------|
| Kulturore | kulturore, historike dhe mjedisore. | |
| | 3.5.3. Përcaktimi i vijës mbrojtëse përgjatë elementeve ujore (vija blu). | <i>Në përputhje</i> |
| | 3.5.4. Rregulla arkitektonike dhe estetike. | <i>Në përputhje</i> |
| | 3.5.5. Rregullat për shfrytëzimin e hapësirave nga “Personat me aftësi të kufizuara”, në përputhje me legjislacionin e posaçëm. | <i>Në përputhje</i> |
| 4. MATERIALI HARTOGRAFIK dhe BAZA E TË DHËNAVE e PPV-së * | | |
| 4.1. Hartat e PPV-së | <p>4.1.1. Hartat shoqërojnë dhe pasqyrojnë të gjitha pjesët përbërëse të dokumentit të PPV-së, sipas <i>Shtojcës I të Rregullores së Planifikimit</i>:</p> <ul style="list-style-type: none"> - me shkallë prezantimi që varion nga 1:5,000 deri në 1:25,000, me përjashtim të analizave në nivel rajoni apo hartave të infrastrukturave publike, kur këto paraqesin elemente që ndodhen jashtë territorit administrativ, si dhe nga 1:5,000 deri në 1:10,000, për zona të rëndësishme urbane; - me simbolet grafike të planifikimit; - në përputhje me specifikimet për bazat e të dhënave, të përcaktuara në rregulloren e regjistrit, në zbatim të ligjit. | <i>Në përputhje</i> |
| 4.2. Baza e të dhënave | 4.2.1. Baza e të dhënave të integruara të territorit në platformën GIS, sipas standardeve të regjistrit të integruar të territorit. | <i>Në përputhje</i> |

* “Analiza dhe Vlerësimi i Territorit të Bashkisë Korçë”, “Dokumenti i Strategjisë së Zhvillimit të Territorit, Bashkia Korçë”, “Plani i Përgjithshëm Vendor, Bashkia Korçë”, “Rregullore e Planit të Përgjithshëm Vendor të Territorit të Bashkisë Korçë” “Vlerësimi Strategjik Mjedisor për Planin e Përgjithshëm Urban në Bashkinë e Korçës”, botuar në Regjistrin e Integruar të Territorit më datë 30.12.2016 me titull “Plani i Përgjithshëm Vendor Bashkia Korçë”.

06.02.2017



UDHËZIME PËR MIRATIMIN E PPV-SË
NË KËSHILLIN BASHKIAK DHE KËSHILLIN KOMBËTAR TË TERRITORIT

A. DOKUMENTET PËR SHQYRTIM

Bazuar në VKM nr. 671, dt. 29.07.2015, “Për miratimin e rregullore së planifikimit të territorit”, materialet që duhen botuar në Regjistrin e Integruar të Territorit përpara miratimit të PPV-SË, janë:

1. **Nisma e miratuar dhe vendimi i miratimit nga Këshilli Bashkiak;**
2. **Dokumentet përbërëse të Planit të Përgjithshëm Vendor:**
 - 2.1. Strategjia Territoriale, shoqëruar me gjetjet e Analizës dhe Vlerësimit të Territorit;
 - 2.2. Plani i Zhvillimit të Territorit, shoqëruar me Shtojcën I të Rregullore së Planifikimit;
 - 2.3. Rregullorja e Planit;
 - 2.4. Vlerësimi Strategjik Mjedisor;
 - 2.5. Materiali Hartografik (sipas Shtojcës I të Rregullore së Planifikimit);
 - 2.6. Baza e të dhënave të integruara të territorit në platformën GIS, sipas standardeve të RIT.
3. **Akti i Përputhshmërisë nga AKPT;**
4. **Deklarata Mjedisore nga Ministri i Mjedisit për VSM-në.**

B. DOKUMENTET PËR MIRATIM

- **TEKST** – Miratim në KB dhe KKT
Plani i Përgjithshëm Vendor, i përbërë nga:
 1. **Strategjia Territoriale**, shoqëruar me gjetjet e Analizës dhe Vlerësimit të Territorit;
 2. **Plani i Zhvillimit të Territorit**, shoqëruar me Shtojcën I të Rregullore së Planifikimit;
 3. **Rregullorja e Planit.**
- **HARTA** – Miratim në KB dhe KKT
 1. **Vizioni Strategjik;**
 2. **Ndarja e Territorit në 5 Sisteme;**
 3. **Ndarja e Territorit në Njësi;**
 4. **Përdorimi i Tokës sipas 14 Kategorive Bazë;**
 5. **Infrastruktura e Transportit;**
 6. **Fazat e Zbatimit të PPV-së.**
- **HARTA** – Miratim në KB

Nga hartat e Shtojcës I të Rregullore së Planifikimit, Këshilli Bashkiak miraton, përveç 6 hartave të mësipërme që miratohen edhe nga KKT, të gjitha hartat e tjera ku reflektohen propozime të planit, që i përkasin Strategjisë Territoriale dhe Planit të Zhvillimit të Territorit.

06.02.2017



13